



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS NOVOBËRD

Numri i lëndës: 2023:287914

Datë: 24.06.2024

Numri i dokumentit: 05853087

C.nr.244/2023

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Dega Novobërdë, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Boban Aleksić, me bashkëpunëtorin profesional Baki Sylejmani, në çështjen juridike kontestuese të paditësit A.M. nga fshati L. i U., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson M. B. avokat nga P. Rr.”R.....”, Hy..... nr..... ,kundër të paditurës Komuna e Novobërdës - Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimi i pagës sipas kualifikimit shkollor-superior, jashtë seancës gjyqësore më datë 24.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditësit A.M. nga fshati L. i U. dhe DETYROHET e paditura Komuna e Novobërdës - Drejtoria Komunale e Arsimit,, që në emër të kualifikimit – Master për periudhën kohore nga data 01.11.2021 – 01.01.2023 , për 14 muaj, duke llogaritur nga 89.03 euro për çdo muaj, t’ia paguaj paditësit shumën prej 1,246.42euro, me kamatë ligjore prej 8 % nga data 19.02.2023, si datë e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

II. DETYROHET e paditura që paditësit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 135 euro, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij më datë 19.12.2023, ka paraqitur padi në këtë gjykatë kundër të paditurës për kompensimin e diferencës në pagë, në emër të kualifikimit, në vlerë të kontestit prej 1,246.42 euro.

Në padinë e dt. 19.12.2023, ka theksuar se i njëjti është i punësuar në SHFMU “Nushi dhe Tefiku” n; cilësinë e mësidhëmësit në fshatin Psjak, komuna e Novobërdës, me kontratë pune me kohë tëa pacaktaur. Përkundër kualifikimit të tij me Master, asnjëherë nuk është kompensuar për aq sa e përcakton baza ligjore për kualifikim nga e paditura si punëdhënë, edhe pse ky ka qenë detyrim i së njëjtës. Për periudhën kohore nga 01.11.2021 – 01.01.2023, për 14 muaj, duke llogaritur nga 89.03 euro për çdo muaj, (sipas 35 % të pagës bazë), me ç’rast Gjykatës i ka propozuar të aprovojë të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe të detyroj të paditurën në kompensimin e shumës së aprovuar si në pikën I

të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumën prej 104.00 euro, për përpilim të padisë dhe 30.00 euro, për taksë gjyqësore.

E paditura, me përgjigje në padi, e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit pa bazë ligjore pasi që e paditura asnjëherë nuk ka paguar punëtorët për kualifikim shkollor dhe se nuk ka bazë ligjore për këtë, siq është shembulli i komunave tjera në Kosovë. E paditura konstaton se kërkesëpadia e paditësit në bazë të Mendimit të Gjykatës Supreme me nr.214/2023 të datës 09.10.2023 në nenin 1 respektivisht në arsyetimin e tij potencon se kualifikimi është i rregulluar me Vendim të Qeverisë së Kosovës nr.01/33 të datës 29.08.2008 ku e njëjta vlen deri më datën 06.02.2023, kur edhe është marrë Vendimi mbi Ligjin e Pagave nr.08/L-196 e cila nuk do të thotë se në praktikën gjyqësore ekzistojnë mendime të ndryshme e lidhur me kualifikimin e cila vërtetohet edhe me vendimin e kontratës kolektive. Në fund ka kërkuar nga gjykata që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seance gjyqësore, bazuar në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), në të cilën është përcaktuar se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit merititor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”.

Gjykata ka gjetur se mes palëve nuk është kontestuese se paditësi është në marrëdhënie punë tek e paditura (fakt i vërtetuar nga Kontrata e punës me nr.01/2014 e datës 01.10.2014 , nuk është kontestuese se i njëjti ka diplomë të nivelit Master nga Universiteti i Prishtinës –Fakulteti Juridik dhe ka marrë titullin LL.M (Master) në të Drejtën ndërkombëtare, (fakt i vërtetuar edhe nga Diploma me nr.rendor 226 e datsë 26 Mars 2015, ndërsa për kualifikim është paguar në shumën prej 58.32 euro (fakt i vërtetuar edhe nga lista e pagës e lëshuar në emër të paditëses nga BRK), nuk është kontestues se paga bazë e të njëjti është 421 euro (fakt ky i vërtetura nga lista e pagës e lëshuar në emër të paditëses nga BRK).

Gjykata bazuar në nenin 329.1 të LPK-së, provat në shkresat e lëndës i gjeti vendimtare për vendosje në këtë çështje meritore, pasi të njëjtat janë lëshuar nga organi shtetëror – këtu vet e paditura, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Gjykata vlerësoi se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit merititor, pasi themelësia e kërkesëpadisë, e aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi del bazuar në Vendimin e Qeverisë, Nr.01/33 të datës 29.08.2008.

Në Vendimin e Qeverisë, Nr.01/33 të datës 29.08.2008, i cili vendim ka qenë në fuqi deri më datë 06.02.2023 (i shfuqizuar me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik, Nr.08/L-196), është përcaktuar se të gjithë mësimdhënësit do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit, pra mësimdhënësve, drejtorëve, zëvendësdrejtorëve dhe bashkëpunorëve profesional, përfitojnë rritje page me diplomë të shkollës normale 10 % të pagës bazë, me diplomë të shkollës pedagogjike me nje ngritje te pagës bazë prej 19%, me diplome universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) **përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%.**

Zbatimi i këtij vendimi të Qeverisë, rastet e kualifikimit-licencimit është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 214/2023 të datës 05.10.2023.

Nga kjo, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi gjeti se e paditura nuk ia ka kompensuar paditësit pagën sipas përqindjes për shkak të kualifikimit shkollor, përkatësisht me Master, pasi është paguar në shumën prej 55.32 euro për kualifikim (fakt i provuar nga lista e pagës), ndërsa sipas përqindjes së përcaktuar në Vendimin e Qeverisë, është dashur të paguhet në shumën prej 145.45 euro , me ç'rast i ka mbetur borxh në shumën prej 89.03 euro, ndërsa periudha e kërkuar për këtë kompensim përfshinë kohën sa ka qenë në fuqi Vendimi i Qeverisë dhe nuk është nuk është e përfshirë në parashkrim siç e pretendon e paditura, pasi bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës, padia është parashtruar më datë 19.12.2023 ndërsa kurse kërkesa është llogaritur për 3 vite mbrapa nga dita e parashtrimit të kërkesës, përkatësisht nga muaji Janar 2021 e që në rastin konkret nuk kemi parashkrim të kërkesës.

Për kamatën, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së.

Lidhur me pretendimin e të paditurës se Vendimi i Qeverisë është zbatuar sipas detyrës zyrtare, gjykata vlerëson se nuk qëndron ky pretendim pasi vendimi nuk është zbatuar në tërësi nga ana e të paditurës si punëdhënëse, përkatësisht të punësuarit janë paguar pjesërisht sipas kualifikimit të tyre, e jo mbi bazën e përqindjes siç e rregullon ky vendim.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore nga neni 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e paditëses në këtë procedurë dhe kërkesën e specifikuar për këto shpenzime, ndërsa sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tarifor 6 dhe 7 të Rregullorës për Tarifën e Avokatëve të Kosovës.

Nga të lartëcekurat, bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 398 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Dega në Novobërdë
C.nr.130/2024, më datë 24.06.2024

Gjyqtari,
Boban Aleksić

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit në Gjykatën e Apelit, përmes këtij Gjykate.